

HYLLI I DRITËS

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas
(11. ad Cor. III. 17).

VOTER
KULTURE
SHOYPTARE

318^b
A
1-19

9-12

Shtatuer-Dhetuer 1943
VJETI XIX.

S H K O D E R

Pajtimi per të perkohshmen „HYLLI I DRITËS“

Shqypni	Nji numer Fr. 1.50	Nji vjetë Fr. 15.—
Ndor vende tjera . . .	„ „ „ 2.—	„ „ „ 20.—

Themelues në vjetin 1913 prej At Gjergj Fishtës

PERMBAJTJA

TH. KAPDIAN — Paraqitja e gjendjes etnologjike në Balkan.	FAQE 309
NORBERT JOKL — Populli shqiptar dhe gjuha e tij.	325
EPRI — Së korrurnash	334
P. BERNARDIN PALAJ — Doke e kanú në Dukagjin.	348
Dr. V. SAMIM VISOKA — Burri Kosovar!	353
A. BENEDIKT DEMA — Shtypi Françeskan në Shqypni.	360
INJAC GJ. NDOJAJ — Pasunija private e Shqipnis.	379
GELASIUS — Fjalori Toponomastik.	391
GJUSH SHELDIJA — Shiroka e gjuetija e peshkut në liqë të Shkodres e në lumet Buenë, Dri e Kír.	407
Fr. ZEF PLLUMI — Martes e pafat.	414
A. D. KURTI — Prralla. — Blë. II. Fash. 18.	



HYLLI I DRITËS

E PERKOHËSHME KULTURALE-LETRARE

Paraqitja e gjendjes etnologjike në Balkan

sidomos mbi Maçedorumenët (Aromunët)

Prej Th. Capidan (Bukarest)

(Vijon prej Nr. vet 6-8, fq. 231)

2. Popujt e Balkanit mbas dyndjes së Slavvet. Bulgarë-Serbët e Shqiptarë-Rumenët.

Slavët kanë luejtë një rrol edhe në dyndjen e vet kah Balkani kohen e shpernguljes së madhe të popujvet, në të cillen moren pjesë Gotët (271-375), Hunnët (375-452), Gepidët (455-566) e Avarët (566-744). Msa pranija e këtyne popujve në Balkan kje vetem per kalim, tue këne se s'lanë mbas vedit kurnji gjurmë, Slavët perkundra, tue shperthye në të gjitha anët ndermjet Hunnvet e Gepidvet, ndërruen që me themel pamjen e gadishullit të Balkanit.

Slavët janë një pjesë e familjes së popujvet indogermanë e duket, se qyshë në fillim janë këne mjaft me shumicë. Banesat më të vjetrat e tynvet duket se janë këne në krahinen ndermjet Vistles e Dnjeprit. Tue perfundue prej pergjasimit gjuhsuer, atje kanë pasë per kufitarë kah lindja popullsi indogermane, prej të cillavet do të dilshin më vonë Indo-Iranët, kah veriprendimi Baltët, qi xunë vend afër fisevet germane, kah jugu Trakët. Në fillim nuk paten një emen të perbashkët; emni *Slovenin* (sh.: *Slovene*), me të cillin i u paraqiten historis, qyshë në kohë të dyndjes së parë të tyne shenjote një pjesë të fisevet brëznije slave. Në të vertetë aj emen kje perdorë deri

